REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 348/19
Datë/Datum. 04.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
AKT PËRCJELLËS

Për:	- Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës – Prishtinë - Parashtruesin e ankesës, Operatorin Ekonomik - "Virtuo" O.P – Prishtinë	Kopje:	Paneli Shqyrtues në OSHP, Arkives në OSHP
Prej:	Safije Saramati – Ekspert shqyrtues i prokurimit Kreshnik Spahiu – Ekspert i jashtëm teknik		
Lënda:	Raport i ekspertit shqyrtues / teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE - "Virtuo" OP – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "*Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së*", me numër të prokurimit 329-19-3253-1-1-1, publikuar nga Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës – Prishtinë.		
Datë	04.07.2019		

Të nderuar,

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin lidhur me ankesën me numër 348/19 të datës 01.07.2019, parashtruar nga OE - "Virtuo" O.P, me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "*Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së*", me numër të prokurimit 329-19-3253-1-1-1, publikuar nga Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës – Prishtinë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas kërkesave të Nenit 115 të LPP-së. Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues -Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës – Prishtinë
- Panelit Shqyrtues në OSHP
- OE ankues -"Virtuo" O.P

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES – TEKNIK

	02.07.2019	02.07.2019	04.07.2019
Nënshkrimi i ekspertit shqyrtues / teknik	*Data e autorizimit të Ekspertit shqyrtues / teknik*	*Data e fillimit të ekspertizës*	*Data e dorëzimit të raportit*

Neni 99 i LPP-së; Baza ligjore e shqyrtimit

Me datë 01.07.2019, OE -"Virtuo" O.P, - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "*Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese të TI-së, si dhe Furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-së*", me numër të prokurimit 329-19-3253-1-1-1, publikuar nga AK – Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës - Prishtinë.
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues / teknik ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

Neni 109 i LPP-së; Operatori Ekonomik - "Virtuo" O.P - Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27/A i LPP-së
Neni 19 dhe 20 i RRUOPP-së

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

AK - Agjencia Kosovare për Krahasim dhe verifikim të pronës ka publikuar njoftimin për kontrate Zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese te TI-se, si dhe furnizim me pajisje përcjellëse për nevojat e AKKVP-se.
Te nderuar ju njoftojmë se ne këtë njoftim dhe në dosje te tenderit autoriteti kontraktues ka bere përshtatje te specifikimeve teknike vetëm për prodhuesit Cisco dhe IBM.

Fillimisht përshtatja e specifikimeve dhe kërkesave teknike është në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 te LPP-se ku shkruan "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike ne at mënyrë që ato të jenë ne përputhje me qëllimin e prokurimit dhe te drejtuara drejt sigurimit te qasjes sa me te mire për te gjithë operatoret e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar qe te hartojë specifikime teknike qe favorizojnë ose diskriminojnë një ose me shume operatorë ekonomik lidhje me këto specifikime teknike ne kemi kërkuar sqarime shtesë nga autoriteti kontraktues me dt: 10.06.2019, ndërsa na kane kthyer përgjigje me dt: 13.06.2019 duke u arsyetuar se janë duke bere zgjerim te infrastrukturës ekzistuese të TI-se dhe se duhet patjetër te veprojnë ne këtë mënyrë sepse pajisjet duhet te jene kompatibile me pajisjet ekzistuese.
Kërkesë e AK-se është fillimisht qe të bëhet zgjerimi i infrastrukturës ekzistuese, mirëpo përveç kësaj kërkohen edhe pajisje te tjera te IT-se, te cilat nuk janë 5 artikujt qe janë ne përshkrim te çmimit, vetëm 3 artikujt e pare kane te bëjnë domosdoshmërisht me infrastrukturën ekzistuese. Duke pasur parasysh faktin se AK-ja po kërkon edhe pajisje tjera atëherë është dashur të hapet konkurrenca, se paku për pajisjet tjera duke e ndare ne Lote këtë aktivitet të prokurimit, sepse pajisjet tjera që kërkohen mund te funksionojnë pa marr parasysh prodhuesve dhe se nuk mund të arsyetohet se edhe këto pajisje domosdoshmërisht duhet te jenë te Cisco dhe IBM. Pra për 12 artikujt tjerë është dashur te behet një Lot i veçante dhe te mos lidhen me 3 pjesët tjera që përshtaten vetëm dy prodhuesve që i përmendëm.

Veprimi i AK-se bie ne kundërshtim edhe me nenin 20.8 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), ku shkruan qartë "Përcaktimi i specifikim në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë një reference tille mund te përdoret ne raste të veçanta, nëse referenca e tille përcjellët me fjalët ose barasvlershme /ekuivalente".

Nëse lejohet te veprohet më tutje me këto specifikime teknike dhe në këtë mënyre, autoriteti kontraktues rrezikon seriozisht te dëmton buxhetin sepse ne momentin kur përshtaten teknike për prodhues te caktuar, atëherë mundësia është shume e madhe qe te ofrohen çmime jo ne vlere tregut por shume me te larta, prandaj edhe rrezikohet te arrihet qëllimi i LPP-se, siç parashihet ne nenin 1 te LPP-se dhe natyrisht cenohet edhe neni 6 i LPP-së.

Madje edhe parim i direktivave te BE-se, është se: "Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabarte për tenderuesit dhe nuk duhet te kenë efektin e krijimit te pengesave te paarsyeshme ne hapjen e konkurrencës se prokurimit publik.

Veprimet e AK-se me këto specifika bëjnë ne kundërshtim edhe me nenin 7. Paragrafi 6 te LPP-se ku Shkruan: Gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (C) pjesëmarrjen sa me te gjerë te mundshme te operatorëve te interesuar lidhur me çmimin dhe lëndën e

prokurimit: () publikimin e rregulli, dërgimin dhe ose 4. disponueshmerine e te gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve qe kane te bëjnë me aktivitetin e prokurimit ne përputhje me ketë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë ne favor ose kundër një ose më shume operatorëve ekonomik:

Ne si operatore ekonomik kemi kërkuar informata shtese nga autoriteti kontraktues, mirëpo nuk na është dhënë asnjë hapësire gjatë përgjigjeve se mund te ofertojmë me pjese ekuivalente.

Autoriteti kontraktues tek aneksi 1 i dosjes se tenderit e ka shënuar se "OE, përkujdesuni qe produktet e ofruara te jenë ekuivalente ose te barasvlershme me Specifikat Teknike paraqitur ne këtë Dokument Tenderik, (faqe 19-50)" Ndërsa tek përgjigja e tyre ne pyetjen tone nr.5 nuk e sqarojnë për Netfloë entries 24000 se a lejohet e barasvlershme, pasi që ne kemi pyetur se a mund te ofertojmë me Sfloë.

Në vendimin e dt:21.06.2019 te autoritetit kontraktues për refuzim te kërkesës pre rishqyrtim, AK ja nuk ka dhënë asnjë përgjigje dhe asnjë sqarim pse refuzohet kërkesa jone për rishqyrtim, pre kërkesën tonë për ndarjen ne lote te këtij tenderi dhe pre ndryshimet e kërkuara nga ana jonë, por e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim shabllon.

Duke u bazuar ne te gjitha sqarimet qe i paraqitëm me lartë, kërkojmë nga OSHP-ja, qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e OE "VIRTUO" O.P, si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi pre kontrate,
DETYROHET- autoriteti kontraktues, që largojë kërkesat dhe specifikimet qe shkojnë në favor te prodhuesve te caktuar, dhe njëkohësisht DETYROHET autoriteti kontraktues qe këtë aktivitet te prokurimit ta ndajë në dy Lote sipas nenit 27/A te LPP-se, një Lot për pajisjet e infrastrukturës ekzistuese dhe një për pajisjet tjera për pajisje përcjellëse e te cilat mund te inkorporohen ne funksionimin e rregullt te infrastrukturës se TI.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Procesi i prokurimit

- Data e publikimit të njoftimit për kontratë: 20.05.2019
- Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
- Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Furnizim / Vlerë e madhe
- Vlera e parashikuar e kontratës:.....402,000.00 €
- Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....Çmimi më i ulët
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....28.06.2019
- Data e kërkesës për rishqyrtim.....20.06.2019
- Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....21.06.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 L-42, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 05 L068. LPP mund të shkarkohet nga krpp.rks-gov.net

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarate e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit Aneksi 2.
2. Vërtetim te lëshuar nga gjykata apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, (jo me e vjetër se 6 muaj para datës se dorëzimit të tenderit - kërkohet origjinali ose kopja e noterizuar).
3. Një vërtetim te lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se dorëzimit të tenderit – kërkohet –kopje.
   Shenim
   Kërkesat në lidhje me pikat 2 dhe 3 si më lartë, duhet të dorëzohen nga Operatori Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate para njoftimit për Dhënie Kontrate; në rast të dështimit për të dorëzuar dokumentet e kërkuara ne piken, 2 dhe 3; i jep te drejte Autoritetit Kontraktues të AKKVP-së, qe ofertën ta refuzoj, dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik të përgjegjëshme e qe është rendit ne vendin e dyte si më i liri, e kështu me radhe.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. Regjistrimi i TVSH
3. Certifkata e Numrit Fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Certifikata e regjistrimit te Biznesit-kopje!
2. Certifikata e TVSH-kopje!
3. Certifikata e Nr. Fiskal- Kopje!
   Shënim me Rëndësi
   Ne rast te shperblimit me kontrate OE te Huaj, Ak i AKKVP do te veproj konform vendimeve dhe rregullave te Administrates Tatimore të Kosovës (ATK).

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

1. OE, duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se Qarkullimi Vjetor i OE, gjatë 3 Viteve të fundit (prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë), ka qenë në vlerë, se bashku ne te tre vitet , prej jo me pak se €800,000.00 - Në rast të Grupit të Operatoreve Ekonomik si dhe konform nenit 27.4 të UOPP; Lideri i Grupit duhet te përmbush se paku 60% te qarkullimit minimal te kërkuar sipas kërkesës 7.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopjet e raporteve financiare për tre vitet e fundit (prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë), dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Në rast se tenderuesi nuk është prodhues i pajisjeve të kërkuar, tenderuesi duhet te dorëzoj Formularin e Autorizimit nga Prodhuesi ose Dilleri i Autorizuar nga Prodhuesi për shitjen e këtyre Produkteve, si pjese e këtij tenderi që oferton.Garancionin
2. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës relevante ose të ngjajshme të Prokurimit, gjate tre (3) viteve të fundit (prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë), ne vlere prej jo me pak se €600,000.00
3. Operatori ekonomik duhet të ofroj katalogu nga prodhuesi me fotografi dhe specifikim teknik detal për secilin produktet te kërkuar nga ana e AK të AKKVP-së, në dosjen tenderike (ANEKS 1).
4. Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi në lidhje me plotësimin e ISO standardeve për produktet e ofruara.
5. a. Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi Listën e të punësuarve që përfshirë Kualifikimet minimale profesionale dhe edukative të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, dhe në veçanti të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve si pjese e këtij tenderi

   b. Menaxheri i projektit i OE, minimumi duhet te jete i kualifikuar ne njërën prej fushave Bachelor i Inxhinierise Elektrike, Bachelor i Inxhinierise Kompjuterike; Bachelor i Shkencave Kompjuterike; ose Ekuivalent;

   c. Menaxheri i Projektit i OE, duhet të ketë Minimumi 3 vite pervoje pune, ne lidhje me Inetgrimin, Instalimin dhe Konfigurimin e Pajisjeve te kerkuara nga AK I AKKVP-se tek Specifikat Teknike ANEKSI I, ose Ekuivalentent; d. OE, Minimumi duhet te prezantoj, tre punëtor te kualifikuar për instalime, konfigurime dhe integrime te pajisjeve te kerkuara nga AK I AKKVP-se tek Specifikat Teknike ANEKS I, ose Ekuivalent. Secili prej këtyre punëtorëve sipas pikes (d) duhet te jete minimumi i kualifikuar ne njeren prej fushave Bachelor i Inxhinierise Elektrike, Bachelor i Inxhinierise Kompjuterike; Bachelor i Shkencave Kompjuterike; ose Ekuivalent;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Autorizimi nga prodhuesi për shitje duhet të jetë në emër te projektit, me numër te Prokurimit si dhe me

informacion te plote te prodhuesit (email, tel, adresa etj) – Original. - Ndersa Autorizimi nga Dileri i autorizuar nga prodhuesi, për shitje duhet të jetë në emër te projektit, me numër te Prokurimit si dhe me informacion te plote te prodhuesit (email, tel, adresa etj) duhet te jete i Noterizuar.

2. Autorizimi nga prodhuesi për shitje duhet të jetë në emër te projektit, me numër te Prokurimit si dhe me informacion te plote te prodhuesit (email, tel, adresa etj) – Original. - Ndersa Autorizimi nga Dileri i autorizuar nga prodhuesi, për shitje duhet të jetë në emër te projektit, me numër te Prokurimit si dhe me informacion te plote te prodhuesit (email, tel, adresa etj) duhet te jete i Noterizuar.
3. Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara gjate tri viteve te fundit (prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë), të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik; - Lista e Kontratave duhet përcjellur (bashkangjitur) minimumin tri (3) referenca ose raporte pranimi, në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse , për furnizimet e realizuar dhe pranuara; te cilat duhet të tregojnë, si më poshtë a. numrin e prokurimit ose kontratës; b. vlerën e kontratës; c. datën e nënshkrimit të kontratës; d. natyrën e prokurimit dhe; e. vendin e realizimit të furnizimeve. Shënim (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raport pranimi reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë. Te gjitha këto dëshmi duhet te kenë vlerën e realizuar. ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
4. Operatori ekonomik duhet të ofroj katalogun nga prodhuesi me fotografi dhe specifikimit detal për secilin produktet te kërkuar. Katalogu mund të dorëzohet në origjinal ose kopje.
5. Certifikatat me ISO standarde për produktet e ofruara duhet të dorëzohet në origjinal ose kopje.
6. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi

   a. Listën e punëtorëve të përhershëm të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim Emri , mbiemrin , mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca(vite) dhe pozicioni në kompani- duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.

   b. Diploma përkatëse e Noterizuar, CV; (Kopja e Diplomës e Noterizuar nga origjinali);

   c. Përvoja e Punës e Menaxherit duhet të dëshmohet me CV dhe kontaktet e personave ku ai ka ofruar shërbimet e tij; e nënshkruar dhe vulosur nga OE.

   d. Diploma përkatëse e Noterizuar, CV; (Kopja e Diplomës e Noterizuar nga origjinali), CV-te e punetoreve te prezentuar per kete prokurim dhe kontaktet e personave ku ata kane ofruar sherbimet e tyre; e nënshkruar dhe vulosur nga OE.

   Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit; duhet të dorëzohet në origjinal,i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.

Neni 113 dhe 114 i LPP-së; Analiza dhe konstatimet e Ekspertit shqyrtues/teknik, sipas ankesës së OE "Virtuo" O.P

Sqarim hyrës - Autoriteti Kontraktues - Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës – Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër specifikimeve teknike në aneksin 1 të Dosjes së Tenderit. Kundër njoftimit për kontratë parashtruesi i ankesës OE - Virtuo" O.P, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me datë 20.06.2019. Me datë 21.06.2019 AK ka nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore si në këtë ankesë, pa dhënë sqarime konkrete për arsyet e refuzimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore - Në lidhje me pretendimet ankimore të OE për përshtatje të specifikimeve teknike për prodhuesit CISCO dhe IBM, eksperti teknik në bazë të kërkime të bëra sqaron si në vijim:

I. Nga hulumtumi i bërë, është evidente se në së paku disa pajisje kanë elemente të specifikimeve teknike që janë karakteristike vetëm për produktet e prodhuesit CISCO.
   a) Në pajisjet e rrjetës, në specifikat teknike është precizuar elementi (protokolli) *NetFlow*. Protokolli *NetFlow* është protokoll i rrjetit i zhvilluar dhe patentuar nga prodhuesi Cisco për përdorim në produktet e këtij prodhuesi. Prodhuesit tjerë kanë protokollet alternative sikurse sFlow të cilin e ka precizuar si mundësi alternative OE ankues.
   b) Po ashtu tek specifikimet teknike për pajisjen "CORE Switch" është kërkuar që të ketë protokollet e autentifikimit: *Kerberos, RADIUS, Secure Shell (SSH), TACACS+*. Marrë parasysh që protokolli *TACACS+* është protokoll i zhvilluar nga Cisco dhe është karekteristikë për produktet e prodhuesit CISCO si dhe faktin që kërkesa përfshinë 4 protokolle të autentifikimi, kjo kërkesë e kufizon konkurencën.

Andaj, rekomandohet që të eliminohen specifikimet që mund të jenë diskriminuese për OE ankues dhe OE tjerë të interesuar në lidhje me këtë aktivitet.
Gjithashtu, kërkesa e AK-së ... "*OE, përkujdesuni qe produktet e ofruara te jene ekuivalente ose te barasvlefshme me Specifikat Teknike paraqitur ne këtë Dokument Tenderik, (faqe 19-50)*", i dhënë në faqen 19 të dosjes së tenderit, duhet të riformulohet konform Nenit 28 të LPP-së, paragrafit 7.

II. Në lidhje me pretendimin se futja e të gjitha pajisjeve bashkarisht (pajisjeve në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese dhe pajisjeve të reja) e ngushton konkurrencën, sqarojmë:

Në këtë aktivitet janë kërkuar pajisje të natyrës së njëjtë (Teknologjisë Informative), përkundër që ndarja në lote do të siguronte një pjesëmarrje më të gjerë dhe konkurrencë më të gjerë, eksperti shqyrtues sqaron se ndarja në lote sipas Neni 27/A të LPP-së dhe Nenint 19, paragrafi 1 të RRUOPP-së, ndarja e kontratave në lote është përgjegjësi e AK-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues / teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues -"Virtuo" O.P, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të obligohet AK që të përmirësoj specifikimet teknike në aneksin 1, të dosjes së tenderit, në pajtim me Nenin 28 të LPP-së. Gjithashtu AK duhet ti njoftoi operatorët ekonomik të interesuar me ndryshimet e dosjes së tenderit dhe të bëj zgjatjen e afatit.